



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagradi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NP TRO-DEX" të datës 08.04.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tregjeve të gjelbra" me nr. të prokurimit 616-25-1169-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NP TRO-DEX" të datës 08.04.2025 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tregjeve të gjelbra" me nr. të prokurimit 616-25-1169-5-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korrigimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korrigimin e kërkesave në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "NP TRO-DEX" (tutje "parashtruesi") me datë 08.04.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i tregjeve të gjelbra" me nr. të prokurimit 616-25-1169-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistonjë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in merito*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi nr. 1 - Ky pretendim ndërlidhet me kërkesën e DT të formuluar si në vijim:

| | |
|--|---|
| Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 40 (katérdhjetë) punëtorë të regjistruar në ATK gjatë tri viteve të fundit | 2. Lista e përgjithshme e punëtorëve dhe e stafit profesional e nënshkruar dhe e vulosur nga operatori ekonomik. Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi me listë nga ATK se ka te punesuar mesatarisht 40 punetore gjate vitit 2023 dhe deri ne muajin Prill 2024 |
|--|---|

Konsiderojmë se ky pretendim ankimor është jo vetëm diskriminues por edhe i pakuptimitë përkatësish i palogjikshëm. Do të ishte krejt në rregull nëse do të kërkohej që ofertuesi të dëshmoj se aktualisht e ka një numër të caktuar të punëtorëve të deklaruar në ATK. Mirëpo kërkesa që ofertuesi të dëshmoj se para 3 viteve ka pasur mesatarisht 40 punonjës, është kërkesë totalisht e pakuptimitë, diskriminuese dhe si e tillë e kundërligjshme. Prandaj kërkojmë që kjo kërkesë ose të largohet tërësisht nga DT ose të paktën të riformullohet pasi që për të realizuar këtë projekt nuk janë të nevojshëm as 30 punonjës dhe lëre më 40 të tillë.

Pretendimi nr. 2 - Ky pretendim ndërlidhet me kërkesat e DT lidhur me stafin profesional (inxhinierët) ku për secilin prej tyre në kuadër të dëshmive dokumentare ndër të tjera është formuluar edhe kërkesa si në vijim: "Dy (2) kontrata të përfunduara me natyrën e kontratës apo të ngjashme (kontrata e skenuar)".

Fillimi nuk ka asnjë kuptim që të kërkohen kontratat e realizuara për inxhinierët. Kjo përsye se kontratat nuk janë lidhur në mes të inxhinierëve (por në mes të OE dhe AK) dhe zakonisht emrat e tyre fare nuk figurojnë në këto kontrata. Do të ishte krejt e logjikshme që të kërkoheshin p.sh referenca për punët e realizuara në të kaluarën, mirëpo jo nga 2 kontrata sepse ato nuk mund të provojnë asgjë për stafin profesional. Vlen të thuhet që kjo është hera e parë në përvojën tonë të gjatë me prokurimin publik, që shohim të vendosura kërkesa të tillë për stafin profesional. Sidoqoftë konsiderojmë që kjo kërkesë është në kundërshtim me nenin 69 par. 6 të LPP si dhe nenin 7 të LPP (kërkesë diskriminuese). Prandaj kërkojmë domosdoshmërisht që kjo kërkesë të largohet nga DT. Në të kundërtën kërkesa e tillë është e kundërligjshme dhe do të kufizoj në mënyrë drastike konkurrencën në mes të OE. Prandaj ne do të shfrytëzojmë të gjitha mijetet ligjore në dispozicion për të garantuar ligjshmërinë në këtë procedurë të prokurimit.

Pretendimi nr. 3 – Ky pretendim ndërlidhet me kërkesën e DT të formuluar si në vijim:

| | |
|--|--|
| 2. Zdrukthtar-i certifikuar nga MPMS per Zdrukthtarë 2 teknik I ndërtimtarisë-i certifikuar nga MPMS per betonues-armirues, 3 vite pervoje pune ne lamite adekuate | <ul style="list-style-type: none"> •Diplomë universitarë •Certifikata nga MPMS •Dy (2) kontrata të përfunduara me natyrën e kontratës apo të ngjashme (kontrata e skenuar), •Kontratën e punës të përhershme ose për këtë projekt me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët; |
|--|--|

Konsiderojmë se kjo kërkesë e DT si e tillë është e panevojshme dhe diskriminuese përfaktin që nuk ka asnjë relevance apo ndikim në realizimin e projektit por paraqet vetëm pengesë për OE dhe kufizim të theksuar me rastin e ofertimit të tyre për këtë aktivitet të prokurimit.

Sa i përket kërkesës për zdrukthtar të certifikuar nga MPMS, kjo kërkesë është e panevojshme pasi që projekti do të realizohet me CLT ku shumica e punës nuk do të realizohet fare në punishte për shkak se materialet do të furnizohen si të parafabrikuara. Pra nuk ekziston asnjë pozicion në paramasë apo në projekt që ndërlidhet me zdrukthtar. Për të marrë një shembull analogjik, kjo është njësoj sikurse në një projekt përfurnizim dhe montim të drithave të kërkohet një xhamprerës, kur dihet se dritharet do të furnizohen si produkte të gatshme nga fabrika. Do të ishte krejtësisht e kuptueshme nëse do të kërkohej si shembull një teknik përpunim të drurit i cili patjetër do të ishte i nevojshëm me rastin e montimit të CLT në pozicionet ku kërkohet përpunimi dhe përshtatja e paneleve me pozicionin përkatës. Mirëpo kërkesa për zdrukthtar është totalisht e panevojshme,

diskriminuese, dhe si e tillë duhet të largohet nga DT ose të lejohet që në vend të tij të prezantohet një teknik përpunim të drurit.

Sa i përket pikës jetër të kërkesës për teknik të ndërtimtarisë të certifikuar përbetonues/armirues nga MPMS, dilema që shtrohet është se cili do të jetë roli i inxhinierëve të ndërtimtarisë nëse kërkohen edhe teknik të ndërtimtarisë të certifikuar nga MPMS. Pra fillimi kërkesa si e tillë është e panevojshme. Ndërsa pjesa e kërkesës përcertifikuesë e dyfishon karakterin diskriminues të kërkesës. Prandaj kërkojmë që edhe kjo pikë e kërkesës së DT ose të largohet në tërësi nga DT ose të korrigohet ashtu që të largohet pjesa e certifikimeve pasi që është e panevojshme në tërësi.

Pretendiimi nr. 4 – Ky pretendim ndërlidhet me kërkesën e DT të formuluar si në vijim:

| | |
|---|--|
| Inxhinier i diplomuar i Ndërtimitatrisë – Strukturë. 3 vite perveje pune(pas diplomimit) ne lamin e ndertimitarise-strukture. | Diplomë universitare • Biografia (CV-në) e nënshkruar nga kandidati; • Dy (2) kontrata të përfunduara me natyrën e kontratës apo të ngjashme (kontrata e skenuar), • Kontratën e punës të përhershme ose për këtë projekt me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët; |
|---|--|

Konsiderojmë se te kjo kërkesë e DT ka ndodhur një gabim teknik për faktin se në RKS nuk ekziston fare drejtimi inxhinier i ndërtimitatrisë – strukturë. Termi “strukturë” me siguri është ndonjë gabim teknik apo gjuhësor që është përvjedhur nga AK. Sido që të jetë, kërkojmë nga AK që të përmisoj këtë kërkesë ashtu që të largoj termin “strukturë”. Në të kundërtën, kërkesa si e tillë është haptazi diskriminuese dhe e kundërligjshme për faktin se nuk ekziston fare një drejtim i tillë në RKS.

Pretendiimi nr. 5 – Ky pretendim ndërlidhet me kërkesën e DT të formuluar si në vijim:

| | | | | |
|---|----------------------|---|--|--|
| 6 | Grejder minimum 16 t | 1 | | |
|---|----------------------|---|--|--|

Në kuptim të nenit 7 të LPP ndalohet që AK të përcaktoj kërkesa në DT të cilat mund të kufizojnë konkurençën ndërmjet OE. Sa i përket kërkesës së lartekur, dilema që krijohet është se cili qenka ai pozicioni që paramasë apo në projekt i cili mund të realizohet me grejder 16 ton mëépo nuk mund të realizohet me grejder 14 ton apo 15 ton! Duke marrë parasysh faktin që nuk ekziston asnjë pozicion i tillë, ju sigurojmë me bindje të plotë profesionale dhe ligjore që në rastin konkret cilido grejder mbi 10 ton është i mjaftueshëm për të realizuar me sukses projektin në fjalë. Sidoqoftë, përmes këtij pretendimi ankimore kërkojmë nga AK që të ndryshoj/plotësoj këtë kërkesë të DT ashtu që të lejoj OE për të ofertuar edhe me grejder më të lehtë sesa 16 ton dhe atë duke filluar nga 13 ton dhe më sipër. Në të kundërtën ju njofojmë se do të kufizohet në mënyrë drastike konkurenca në mes të OE për arsy se ekzistojnë shumë pak kompani në RKS të cilët posedojnë grejder mbi 16 ton.

Pretendimi nr. 6 – Ky pretendim ndërlidhet me faktin se ka mospërputhje të theksuara ndërmjet paramasës dhe projektit. Si fillim duhet theksuar që në paramasë ekzistojnë disa pozicione ku nuk është përektuar konkretisht njësia matëse por është evidentuar si “pashall”. Me këtë rast e njofojmë AK që me rastin e ofertimit, në do të plotësojmë paramasën ashtu sikurse është ngarkuar nga AK në cprokurimi. Mirëpo paraprakisht e njofojmë AK që të konfirmoj nëse ekziston mundësia që në vend të pashallit të specifikoj njësitet kërkuesi aty ku kjo është e mundur.

Tutje, në paramasë të pjesë “modulel” është këruar që kulmi të realizohet me CLT 90 mm. Me përgjegjësi të plotë profesionale, morale dhe ligjore ju konfirmojmë se CLT 90 mm nuk ka integritet struktural dhe si i tillë përdoret vetëm për ndarjen e hapësirave të brendshme në objekte por jo për kulme. Prandaj aktualisht nuk ekziston asnjë fabrikë në botë prodhon dhe

garanton integritetin struktural të CLT 90 mm për kulme. Ky fakt mund të konfirmohet lehtësisht nga AK nëse parashtron pyetje të cilado fabrikë në botë që merret me prodhimin e CLT. Të gjitha fabrikat e botës që prodhojnë CLT, produket e tyre i ofrojnë në dimensionet 80, 100, 120, 160, 180, etj. Prandaj duke marrë parasysh këtë fakt, kërkojmë nga AK që në kuptim të nenit 28 par. 6 dhe 7 të LPP të lejoj për pozicionet kulmet CLT 90 mm të ndryshohet ditë të lejohet CLT 80mm pasi që CLT 90 mm nuk ekziston dle nuk garanton askush në botë integritet struktural. Ndërsa sa i përket pozicioneve për “mure CLT 60 mm” dhë “mure CLT 19 mm” kërkojmë që për shkak të integritetit struktural, të lejohet edhe pjesa “ose ekivalente” (shih tabelën në vijim). Përmes nenit 28 par. 7 të LPP konkretisht përcaktohet se “*Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësisëshëm, ose ndonjë shenje dalluese. Iloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Pavarësisht nga e mësipërmja, autoriteti kontraktues mundet, që nuk kushti të jashtëzakonshme, të hartojë specifikime teknike ose të bëjë një referim të tillë të veçantë, nëse autoriteti kontraktues në mënyrë të qartë vërteton se, nuk është e mundur që të përpilojë një specifikim mjaft të saktë dhe të kuptueshëm të lëndës së kontrates përkatëse, në pajtim me paragrafin 3-6. të këtij nenit ose ndryshe; me kusht që, qfarëdo referimi i tillë të shoqërohet me fjalët “ose ekivalente”.*”

Tutje duhet shuar se ekzistojnë edhe disa pozicione të tjera të cilat në paramasë janë evidentuar ndryshme ndërsa në projekt janë evidentuar krejt ndryshe. Me qëllim që të shumangen të gjitha keqkuptimet eventuale në fazën e realizimit të projektit, kërkojmë nga AK që të korrigoj paramasën duke e harmonizuar të njëjtën me projektin ekzistues. Për këtë qëllim, në vijim gjeni pozicionet me ngjyrë të kuqe të cilat duhet të revidohen në paramasë me qëllim të harmonizimit të tyre me projektin.

| | | | |
|-------|---------------------------------|----------------|-----|
| 2.1.2 | Mure CLT ose ekivalente - 60 mm | m ² | 4.3 |
| 2.2.1 | Kulmi CLT 80mm | m ² | 6.7 |
| 2.2.2 | Muret CLT ose ekivalente - 19mm | m ² | 4.3 |

Faqe 3 nga 5

Adresa: Rr. “UÇK” nr. 2, Prishtinë 10000

Tel.: 038-200-40-111

Email: visar.shehu@rks-gov.net

Lidhur me pretendimin nr. 1 – Pas analizimit me kujdes të projektit dhe paramasës, është gjetur se për realizimin me sukses të kontratës nuk janë të domosdoshme 40 punonjës. Megjithatë 30 punonjës sikurse janë kërkuar nga parashtruesi janë të pamjaftueshëm. Prandaj ky pretendim ankimore është gjetur vetëm si pjesërisht i bazuar ashtu që do të korrigohet dosja e tenderit dhe nga 40 do të kerkohen vetëm 35 punonjës.

Lidhur me pretendimin nr. 2 – duke analizuar kërkesën e DT në kuptim të nenit 69 të LPP, është gjetur se kërkesa “*Dy (2) kontrata të përfunduara me natyrën e kontratës apo të ngjashme (kontrata e skenuar)*” në kuadër të dëshmisë dokumentare për stafin profesional, si e tillë është kërkesë e panevojshme. Kjo për arsyen se përmes kontratave përkatëse nuk mund të konfirmohet përvaja e punës për inxhinierët përkatës sepse në kontratë evidentohen vetëm palët kontraktuese (OE dhe AK) por jo edhe stafi. Rrjedhimisht kontratat e tilla nuk mund të zëvendësojnë referencat apo CV apo kontratat e punës. Prandaj pretendimi ankimore është gjetur si i bazuar në tërësi ashtu që duhet larguar kjo kërkesë si dëshmi dokumentare për të gjitha kërkesat përkatëse për staf profesional.

Lidhur me pretendimin nr. 3 – ky pretendim ankimore i referohet kërkesës së DT si vjon:

| | |
|--|--|
| 2. Zdrukthtar- i certifikuar nga MPMS per Zdrukthtarë 2 teknik I ndertimtarise- i qertifikuar nga MPMS per betonues-armirues. 3 vite pervoje pune ne lamite adekuate | •Diplomë universitare •Certifikata nga MPMS •Dy (2) kontrata të përfunduara me natyrën e kontratës apo të ngjashme (kontrata e skenuar), •Kontratën e punës të përhershme ose për këtë projekt me OE-në, të nënshkruar nga të dy palët; |
|--|--|

Sa i përket kërkesës për zdrukthtar, pas analizimit me kujdes të projektit dhe paramasës është gjetur se kërkesa për zdrukthtar nuk është kërkesë e domosdoshme përfaktin që shumica absolute e punës do të realizohet jashtë vendpunishtes ku do të realizohet kryesisht pjesa e montimit të paneleve CLT. Pra askund nuk do të mund të hyj në funksion zdrukthtar gjatë realizimit të kontratës. Kësisoj në këtë pikë ky pretendim ankimore është gjetur i bazuar ashtu që kjo pikë e kërkesës së DT për zdrukthtar do të largohet në tërësi nga DT.

Sa i përket pikës tjeter për teknik të ndërtimtarisë të certifikuar nga MPMS për betonues dhe armirues, është gjetur se kjo pikë e pretendimit është vetëm pjesërisht e bazuar. Fillimisht në projekt dhe paramasë nuk është e domosdoshme që të ekzistoj një person i certifikuar për betonues-armirues. Mirëpo edhe po të ekzistonte nevoja për një person të tillë, atëherë do të duhej që kjo kërkesë të ndahej nga kërkesa për teknik të ndërtimtarisë. Rrjedhimisht është gjetur se pretendimi ankimore është pjesërisht i bazuar ashtu që do të largohet kërkesa për zdrukthtar dhe pjesa e certifikimeve të MPMS për betonues-armirues mirëpo do të mbetet kërkesa për teknik të ndërtimtarisë.

Lidhur me pretendimin nr. 4 – ky pretendim ankimore është i saktë pasi që ka ndodhur një gabim teknik gjatë formulimit të kërkesës së DT. Prandaj do të korrigohet kërkesa e DT duke larguar termin “strukturë” dhe mbetet vetëm “inxhinier i dip. i ndërtimtarisë”.

Lidhur me pretendimin nr. 5 - pas analizimit të projektit dhe paramasës është gjetur se kërkesa për greder 16 ton mund të korrigjohet mirëpo jo në 13 ton sikurse ka kërkuar parashtruesi por pesha e grejderit duhet të jetë së paku 15 ton. Prandaj ky pretendim ankimore është vetëm pjesërisht i bazuar ndërsa kërkesa e DT do të korrigjohet ku grejderi min. 16 ton do të korrigjohet duke kërkuar vetëm grejderi min. 15 ton.

Lidhur me pretendimin nr. 6 - pas analizimit dhe korrigjimit të paramasës dhe projektit është gjetur se pretendimi është i bazuar pasi që është konfirmuar se mes tyre ekzistojnë disa mospërputhje të cilat do të korrigjohen në pozicionet si në vijim:

| | | | |
|-------|----------------------------------|----------------|-----|
| 2.1.2 | Mure CLT ose ekuivalente - 60 mm | m ³ | 4.3 |
| 2.2.1 | Kulmi CLT 80mm | m ³ | 6.7 |
| 2.2.2 | Muret CLT ose ekuivalente - 19mm | m ³ | 4.3 |

Po ashtu do të rishqyrtohen edhe pozicionet ku njësi matëse është paushall nëse eventualisht është e mundur që të specifikohet njësia kërkuese ose jo.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnje aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik".

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënët më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 15.04.2025



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.